

VENDIM
Nr. 247, datë 29.9.2022

**MBI LICENCIMIN E “BURSËS SHQIPTARE TË ENERGJISË
ELEKTRIKE–ALPEX” SHA, NË VEPRIMTARINË E OPERIMIT TË TREGUT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “dh”, dhe nenit 58, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “P”, nenit 5, pika 1, germa “P” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.9.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1625/5 prot., datë 27.9.2022, “Mbi licencimin e ‘Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike–ALPEX’ sh.a. në veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 183, datë 13.7.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike–ALPEX” sh.a.

- ERE ka bërë njoftimin në medien e shkruar për këtë vendimmarrje, i cili është botuar në datat 15.7.2022 dhe 16.7.2022, dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve të mundshme nga të tretët (data 28.7.2022) nuk ka rezultuar të ketë të tilla.

- Duke qenë se lindi nevoja për të qartësuar statusin e miratimit të dokumenteve për ushtrimin e veprimtarisë së OT-së, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 214, datë 24.8.2022, vendosi të shtyjë vendimmarrjen për licencimin e “Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike–ALPEX” sh.a. në veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike.

- Në vijim të sa më sipër, në datën 12.9.2022, u zhvillua seanca dëgjimore me përfaqësuesit e shoqërisë “ALPEX” sh.a. dhe iu la detyrë përcjellja në formë shkresore e sqarimeve që u dhanë edhe në seancë.

- Për sa kërkohet, shoqëria “ALPEX” sh.a. paraqiti në ERE nëpërmjet shkresës nr. 966/5 prot., datë 20.09.2022, sqarimet/dokumentet përkatëse.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik dhe administrativ; dokumentacionin financiar dhe fiskal; si dhe dokumentacionin teknik për veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim, shoqëria ka përcjellë tërësisht dokumentacionin e kërkuar nga rregullorja.

- Duke qenë se draftrregullorja për mbrojtjen dhe sigurinë e informacionit konfidencial dhe të brendshëm, e depozituar në ERE, nuk është miratuar ende, vlerësohet që shoqëria ta depozitojë atë pas miratimit.

- “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike–ALPEX” sh.a. është krijuar në bazë të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, VKM-së nr. 519, data 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”; VKM-së nr. 609, datë 11.9.2019, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së pjesëmarrësve në kapitalin e operatorit të tregut”. Kjo shoqëri do të operojë tregun shqiptar të energjisë elektrike dhe po ashtu ka hapur degën e saj edhe në Kosovë, sipas vendimit nr. 1, datë 27.1.2021, “Për miratimin e hapjes së Degës së Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike në Kosovë”.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit, në zbatim të përcaktimeve të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike–ALPEX” sh.a., në aktivitetin e operimit të tregut të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti